




Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, në bazë të kompetencave të dhëna me nenin 4 paragrafi 2 dhe neni 3.6 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, neni 8 paragrafi 2 pika a, të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, dhe me qëllim të zbatimit të masave për parandalimin dhe luftimin e infeksionit COVID 19, me datën 29.03.2022, nxjerr:



VENDIM

Për masa të reja lidhur me pezullimin e ndërprerjeve të shërbimeve të ujësjetës

1. Me qëllim të ofrimit të shërbimeve të ujit të pijshëm gjatë kohëzgjatjes së pandemisë Covid 19, pezullohen ndërprerjet e ujit për mos pagesë të shërbimeve vetëm për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak, deri në një vendim tjetër.
2. Pika 1 e këtij vendimi nuk zbatohet në raste kur:
 - 2.1. Konsumatori i përket kategorisë së konsumatorëve Komercial/Industrial apo Institucional.
 - 2.2. Uji keqpërdoret nga konsumatorët.
 - 2.3. Rrjeti i shpërndarjes së shërbimeve të ujësjetës është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes së madhe ose të shkatërrimit;
 - 2.4. Ofruesi i shërbimeve ka për qëllim riparimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetës (në këto raste, konsumatorët duhet të njoftohen paraprakisht për kohëzgjatjen e ndërprerjes);
 - 2.5. Vlerësohet se vazhdimi i ofrimit të shërbimeve paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e personave fizik;
3. Ofruesve të shërbimeve në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, nuk ju ndaloheq që t'i përdorin të gjithë mekanizmat e tjerë për inkasimin e detyrimeve që i kanë konsumatorët për shërbimet e pranuar.
4. Shfuqizohet Vendimi me nr. 127/D datë 22.04.2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe është i vlefshëm deri në një vendim tjetër.

ARSYETIM

Meqenëse situata e gjendjes emergjente e krijuar nga COVID-19 po vazhdon, me qëllim të mbrojtës së jetës dhe shëndetit të qytetarëve, të cilët në gjendjen e krijuar duhet të kanë ujë të mjaftueshëm, qoftë për pije, higjienë dhe për nevoja të amvisërisë, ARRU ka obliguar ofruesit e shërbimeve që të kenë kujdese gjatë ndërprerjeve të ujit për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak, përveç rasteve sipas pikës 2 këtij vendimi.

Prandaj, duke pasur parasysh se shërbimet e ujit janë shërbime jetike, sidomos në gjendjen emergjente të krijuar nga Covid-19 dhe me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të OBSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë, për

ngritjen e nivelit të higjienës si një ndër masat kryesore për parandalimin dhe luftimin e infeksionit COVID 19, si dhe duke marrë parasysh edhe praktikatat e njëjta të vendeve anëtare të shoqatës së Rregullatorëve Evropian (WAREG), ARRU ka vendosur të vazhdoj me pezullimin e ndërprerjet e ujit, për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqes kundërshtim në Komisionin Shqyrtues në afat prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- *Arkivit të ARRU-së;*
- *Departamenteve të ARRU;*
- *Njësisë për Inspektim,*
- *Kryeshefave të të gjithë KRU-ve*

Drejtoresha

Hajrije MORINA

